



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna Podujevë / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KOMUNA E PODUJEVËS
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
18.03.2026

Bazuar në nenin 62 pika 3, të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, Rregulloren MF-Nr.04/2017, mbi kriteret standarde dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 61 paragrafi 1 dhe 2 të statutit të Komunës së Podujevës nr. 01020/01-0050862/18 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e Thirrjes Publike për Mbështetje Financiare Publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore në Komunën e Podujevës nr. Protokollit 02-400/03-0016455/26 të datës 17.03.2026.

THIRRJE PUBLIKE

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore në Komunën e Podujevës.

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës, u bën thirrje të gjitha OJQ-ve të regjistruara në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e organizimeve rinore dhe kulturore, promovimin përmes pasurimit, diversifikimit dhe rritjes së cilësisë së jetës kulturore dhe rinore, gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Podujevës.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt/propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore.
3. OJQ – të, mund të aplikojnë me vetëm një projekt që kontribuon në organizimet kulturore dhe rinore përmes aktiviteteve si më poshtë:

1. Kinematografi (projekt të filmit, festivalit apo dokumentarit);
2. Vallëzim;
3. Aktivitete dhe manifestime për shënimin e datave të rëndësishme në Komunën e Podujevës;
4. Art në hapësira publike;
5. Promovim të turizmit kulturor;
6. Festival lokale (muzikë, teatër, film dhe art bashkëkohor);
7. Trajnime për art, dizajn, muzikë dhe film;
8. Panair të librit;
9. Panair në artin tradicional, trashëgimin kulturore dhe punime artizanale;
10. Panairi i punës;
11. Promovim të trashëgimisë kulturore;

12. Edukimi joformal;
 13. Aktivitete argëtuese për fëmijë;
 14. Punëtori me të rinjtë;
 15. Kampe rinore;
 16. Vullnetarizëm;
 17. Trajnime për lidërsip dhe pjesëmarrje qytetare
 18. Fuqizim i pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje;
 19. Programe për zhvillim të shkathtësive (soft skills)
 20. Shkencë dhe digjitalizim;
 21. Vetëdijësim dhe mendim kritik
 22. Çiklizëm, ecje dhe vrapim;
 23. Ambient dhe teknologji
 24. Teknologjia dhe njeriu
 25. Programe, projektet apo aktivitetet mbi ndërgjegjësimin në raport me shëndetin mendor
 26. Programe, projekte apo aktivitete mbi multikulturalizmin; dhe
 27. Programe, projektet apo aktivitetet të tjera për kulturë dhe rini. të tjera në kulturë dhe arte.
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes për subvencione për kulturë dhe rini është 40,000 € (euro). Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 300 € (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është 3,000 € (euro).
 5. OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt.
 6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë.
 7. Periudha e zbatimit të projektit është nga nënshkrimi i kontratës deri më 30.12.2026.
 8. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data 18.03.2026 dhe përfundon me datën 10.04.2026 në ora 16:00.

Cilat janë objektivat e thirrjes?

- a) Hartimi, planifikimi dhe zbatimi i programeve/projekteve apo aktiviteteve rinore nëpërmjet të cilave identifikohen dhe adresohen kërkesat e të rinjve dhe promovohet zhvillimi i rinisë.
- b) Hartimi, planifikimi dhe zbatimi i programeve/projekteve apo aktiviteteve kulturore nëpërmjet të cilave promovohet zhvillimi i jetës kulturore.
- c) Promovimi dhe zhvillimi i kinematografisë, artit dhe vallëzimit;
- d) Organizimin e festivaleve, panairove dhe manifestimeve kulturore;
- e) Promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;
- f) Promovimi dhe zhvillimi i turizmit;
- g) Fuqizimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje;
- h) Fuqizimi i njohurive dhe aftësive të të rinjve nëpërmjet edukimit joformal;
- i) Fuqizimi i vullnetarizmit të të rinjve;

- j) Fuqizimi i mendimi kritik tek të rinjtë;
- k) Promovimi i shkencës, teknologjisë dhe ambientit;
- l) Fuqizimi i vetëdijesimit mbi shëndetin mendor;
- m) Fuqizimi i bashkëveprimit kulturor dhe rinor mbi premisën e multikulturalizmit;

Cilat janë kriteret e përgjithshme?

1. OJQ-të duhet të veprojnë në Republikën e Kosovës;
2. Projektet duhet të zbatohen në Komunën e Podujevës;
3. OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Podujevës;
4. OJQ-të të cilët nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje dhe nuk mund të përzgjidhen fituese;
5. Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
6. Projektet duhet të reflektojnë objektivat e përcaktuar dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në kuadër të thirrjes publike;
7. Të mos ekzistojë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
8. OJQ-të nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Podujevës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme. Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Podujevës;
9. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat si të cekura më lartë. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Podujevës dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;

Cilat dokumente duhet dorëzuar?

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
2. Certifikata e nr. fiskal;
3. Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së. **Vëmendje:** jo kopje e kartelës bankare;
4. Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
5. Vërtetimin që OJQ nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
6. Deklarata për financimin e dyfishtë (nëse ka);
7. Deklarata e partneritetit; (nëse ka);
8. Formulari i projekt-propozimit të thirrjes publike;
9. Formulari i propozim-buxhetit;
10. Udhëzuesi për aplikuesit.

Dokumentet e kompletuara duhet të vendosen në zarf dhe të dorëzohen në: Ndërtesa e Komunës së Podujevës, Rr. Nuhi Gashi, në Zyrën për Shërbim të Qytetarëve. Në zarf duhet të shkruhet: *Aplikim në kuadër të Thirrjes për Projekt-Propozime për vitin 2026.*

Vëmendje:

1. Aplikacionet të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen;
2. Dokumentet e dorëzuar pas përfundimit të afatit në kuadër të thirrjes publike nuk do të pranohen.
3. Ngarkimi i gabuar i dokumentacionit ose dokumentacioni i skanuar jo në formën e duhur, rrjedhimisht me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit.
4. Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë.
5. Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndryshuar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë të dhënat në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.
6. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në Rregulloren për subvencione.

Hapat që duhet ndjekur pas realizimit të projektit/programit apo aktivitetit:

Pas përzgjedhjes dhe realizimit të projektit, përfituesi është i/e obliguar që të dorëzojë brenda afatit kohor raportin narrativ dhe raportin financiar. Raportet duhet të përgatiten në mënyrë elektronike.

- a) raporti narrativ - përfshin dëshmi nga projekti i aktivitetit, siç janë fotografitë apo listat e pjesëmarrësve. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga përfituesi dhe të dorëzohet pas përfundimit të projektit.
- b) Raporti financiar - kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njëjtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në raportin financiar duhet të përshkruhen shpenzimet në përputhje me buxhetin origjinal duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera, si dhe të evidentoj çdo fond të pashpenzuar (të cilat duhet të kthehen ose për të cilat kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit). Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga përfituesi dhe të dorëzohet pas përfundimit të projektit.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të vazhdoj procedurat e realizimit të thirrjes publike në përputhje me normat dhe rregullat ligjore.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: jakup.gashi@rks-gov.net dhe omer.kosumi@rks-gov.net ose në hapësirat e DKRS në objektin e Komunës.



Drejtoreshë
Për Kulturë, Rini dhe Sport
Valbona Ibishi Azemi